



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Ex officio nr. 401/2018

RAPORT ME REKOMANDIME

I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

në lidhje me

Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave

Drejtuar:

Z. Shpend Ahmeti-Kryetar i Komunës së Prishtinës,
Z. Burim Berisha-Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës,
Z. Agim Aliu-Kryetar i Komunës së Ferizajt,
Z. Agim Veliu-Kryetar i Komunës së Podujevës,
Z. Ardian Gjini-Kryetar i Komunës së Gjakovës,
Z. Lutfi Haziri-Kryetar i Komunës së Gjilanit,
Z. Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës së Lipjanit,
Z. Zenun Elezaj-Kryetar i Komunës së Klinës,
Z. Haki Rugova-Kryetar i Komunës së Istogut,
Z. Gazmend Muhaxheri-Kryetar i Komunës së Pejës,
Z. Bashkim Ramosaj-Kryetar i Komunës së Deçanit,
Z. Smajl Latifi-Kryetar i Komunës së Rahovecit,
Z. Qëndron Kastrati-Kryetar i Komunës së Kamenicës,
Z. Ragip Begaj-Kryetar i Komunës së Malishevës,
Z. Besim Ilazi-Kryetar i Komunës së Kaçanikut,
Z. Rufki Suma-Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit,
Z. Xhafer Gashi-Kryetar i Komunës së Obiliqit,
Z. Shaban Shabani-Kryetar i Komunës së Dragashit,
Z. Bali Muharremaj-Kryetar i Komunës së Suharekës,
Z. Agim Bahtiri-Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut,
Z. Goran Rakić-Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore,
Z. Vučina Janković-Kryetar i Komunës së Zveçanit,
Z. Svetislav Ivanović-Kryetar i Komunës së Novobërdës,
Z. Ramiz Lladrovci-Kryetar i Komunës së Drenasit,
Z. Naim Ismajli-Kryetar i Komunës së Shtimes,
Z. Bekim Jashari-Kryetar i Komunës së Skenderajt,
Z. Sokol Haliti-Kryetar i Komunës së Vitisë,

Prishtinë, më 25 tetor 2018

Qëllimi

1. Ky Raport me Rekomandime ka për qëllim të vlerësojë gjendjen e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të varrezave në komunat e Republikës së Kosovës, me fokus të veçantë vlerësimin e gjendjes reale të varrezave, si dhe të rekomandoj autoritetet përgjegjëse, në lidhje me masat që duhet ndërmarrë në mënyrë që kjo gjendje të përmirësohet.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

2. Sipas nenit 135, paragrafi 3 të Kushtetutës, "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*"
3. Gjithashtu, sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mes tjerash Avokati i Popullit ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut" (neni 16, paragrafi 4).*
 - *tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla; (neni 18, nën paragrafi 1.2).*
 - *të rekomandoj Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit; (neni 18, nën paragrafi 1.5).*
 - *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; (neni 18, nën paragrafi 1.6).*

Përshkrimi i gjendjes dhe veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

4. Duke pasur parasysh se menaxhimi dhe mirëmbajtja e varrezave është veprimtari komunale e interesit të përgjithshëm, duke u bazuar në informatat e grumbulluara lidhur me gjendjen jo të mirë të mirëmbajtjes së varrezave, Avokati i Popullit, me datë 21 qershor 2018, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka iniciuar hetime me iniciativën e vet (*ex officio*) lidhur me vlerësimin e gjendjes së varrezave nëpër komunat e Republikës së Kosovës.
5. Me qëllim të vlerësimit të gjendjes së varrezave dhe mirëmbajtjes së tyre, përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), kanë vizituar disa varreza nëpër komunat e Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtyre vizitave ishte që të ofrohet një përshkrim i gjendjes së tyre duke pasur parasysh kriteret më bazike që një varrezë duhet plotësuar për të qenë e qasshme, e dinjitetshme dhe të plotësojë nevojat e qytetarëve.
6. Gjatë vizitave të këtyre varrezave nga përfaqësuesit e IAP, janë identifikuar disa çështje më elementare, të cilët duhet të adresohen nga autoritetet kompetente komunale, më

qëllim të rregullimit dhe avancimit të gjendjes së menaxhimit dhe mirëmbajtjes aktuale të varrezave nëpër disa nga komunat e Republikës së Kosovës.

7. Varrezat e qytetit në Prishtinë kanë rrethoja mirëpo ato nuk janë të kompletuara dhe të mirëmbajtura, ndërsa në disa pjesë mungon rrethoja tërësisht. Përkujdesja për pastërtinë dhe gjelbërimin në varreza nuk është në nivelin e duhur. Ka mbeturina dhe disa varreza janë të mbuluara nga bari. Në disa pjesë të varrezave mungojnë shtigjet për këmbësorë ndërsa edhe shtigjet ekzistuese nuk mirëmbahen sa duhet. Lokacioni i varrezave nuk është i përshtatshëm pasi që terreni është mjaft i pjerrët. Varrezat ortodokse dhe katolike kanë rrethojën, mirëpo varrezat nuk kanë mirëmbajtje të nevojshme të gjelbërimit. Disa nga varret janë të mbuluara me bar e shkurre dhe nuk ka shtigje të mjaftueshme për këmbësorë.
8. Varrezat e qytetit të Podujevës janë të rrethuara me rrethojë e cila është e kompletuar dhe e mirëmbajtur. Në varreza nuk ka shtigje të mjaftueshme për këmbësorë, mirëmbajtja e pastërtisë dhe gjelbërimit është në nivel. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm por nuk ka hapësirë të mjaftueshme për parkim të automjeteve. Varrezat ortodokse kanë rrethojë e cila është shumë e dëmtuar, nuk kanë shtigje për këmbësorë, gjelbërimi nuk mirëmbahet, bari dhe shkurret kanë mbuluar varrezat dhe nuk vërehet ndonjë mirëmbajtje e tyre.
9. Varrezat e qytetit të Ferizajt, janë të rrethuara me rrethoja dhe kanë shtigje për këmbësorë. Mirëmbajtja e pastërtisë dhe gjelbërimit nuk është në nivelin e duhur. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm por nuk ka hapësirë për parkim të automjeteve. Varrezat ortodokse kanë rrethojë por nuk kanë shtigje për këmbësorë, gjelbërimi nuk mirëmbahet, bari dhe shkurret kanë mbuluar një pjesë të varrezave dhe nuk vërehet ndonjë mirëmbajtje e tyre.
10. Në varrezat e qytetit në Gjakovë, janë të rrethuara me rrethojë, kanë shtigje për këmbësorë dhe ka mirëmbajtje të gjelbërimit dhe pastërtisë në varreza. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm dhe hapësira për parkim të automjeteve është e mjaftueshme. Varrezat ortodokse kanë rrethojë, bari dhe shkurret kanë mbuluar varrezat dhe nuk vërehet ndonjë mirëmbajtje e tyre.
11. Varrezat e qytetit në Gjilan kanë rrethoja të kompletuara dhe të mirëmbajtura. Në varreza ka shtigje për këmbësorë mirëpo në disa pjesë mirëmbajtja e gjelbërimit dhe pastërtisë nuk është në nivelin e duhur. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm dhe ka hapësira për parkim të automjeteve. Në varrezat ortodokse nuk ka shtigje për këmbësorë, gjelbërimi nuk mirëmbahet, bari dhe shkurret kanë mbuluar varrezat dhe nuk vërehet ndonjë mirëmbajtje e tyre.
12. Në Mitrovicën e Jugut, varrezat e qytetit janë të rrethuara me rrethojë, e cila është e kompletuar, kanë shtigje për këmbësorë dhe mirëmbajtja e gjelbërimit dhe pastërtisë është në nivel të mirë. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm dhe ka hapësirë për parkim për automjete. Varrezat ortodokse janë të rrethuara me rrethojë por nuk ka shtigje për këmbësorë, gjelbërimi nuk mirëmbahet, bari dhe shkurret kanë mbuluar një pjesë të varrezave dhe nuk vërehet ndonjë mirëmbajtje e tyre.

13. Në Zveçan (në fshatin Rudare) varrezat janë të rrethuara me rrethojë, e cila është e kompletuar. Varrezat nuk kanë shtigje të mjaftueshme për këmbësorë dhe mirëmbajtja e gjelbërimit dhe e pastërtisë është relativisht e mirë. Lokacioni dhe qasja në varreza është e përshtatshme. Në Mitrovicën e Veriut, varrezat myslimane kanë rrethojë por është e dëmtuar dhe e pa mirëmbajtur. Nuk ka shtigje për këmbësorë dhe mirëmbajtja e gjelbërimit dhe pastërtisë në varreza nuk është në nivel.
14. Varrezat e qytetit të Prizrenit kanë rrethoja të kompletuara dhe të mirëmbajtura, gjelbërimi në varreza mirëmbahet dhe pastërtia është në nivel të mirë. Shtigjet për këmbësorë nëpër varreza janë të rregulluara, lokacioni i varrezave është i përshtatshëm por mungon hapësira për parkim të automjeteve. Varrezat ortodokse gjenden në afërsi të varrezave të qytetit, kanë rrethojën, shtigjet për këmbësorë dhe mirëmbajtje të pastërtisë dhe gjelbërimit.
15. Në Lipjan, varrezat e qytetit janë rregulluar në vitin 2016, shtigjet për këmbësorë janë të mjaftueshme, varrezat janë të rrethuara me rrethojë e cila është e kompletuar dhe mirëmbajtja e pastërtisë dhe gjelbërimit është në nivel të mirë. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm dhe ka hapësirë për parkim të automjeteve. Varrezat ortodokse kanë rrethojën por nuk kanë shtigje për këmbësorë dhe nuk vërehet se ka mirëmbajtje të gjelbërimit dhe pastërtisë.
16. Varrezat e qytetit të Obiliqit janë të rrethuara me rrethojë e cila është e kompletuar, shtigjet për këmbësorë nuk janë të mjaftueshme dhe mirëmbajtja e gjelbërimit nuk është e plotë. Mirëmbajtja e pastërtisë është në nivel, lokacioni i varrezave është i përshtatshëm dhe ka hapësirë për parkim të automjeteve. Varrezat ortodokse janë të rrethuara me rrethojë, nuk ka shtigje për këmbësorë dhe nuk vërehet se ka ndonjë mirëmbajtje apo përkujdesje për këto varreza.
17. Në Fushë Kosovë, në varrezat e qytetit vërehen mangësi sa i përket mirëmbajtjes së pastërtisë dhe gjelbërimit në varreza. Varrezat nuk kanë shtigje të mjaftueshme për këmbësorë dhe nuk janë të mirëmbajtura sa duhet. Lokacioni është i përshtatshëm, varrezat janë të pajisura me rrethoja të cilat janë të mirëmbajtura dhe ka hapësirë për parkim të automjeteve. Varrezat ortodokse nuk janë të mirëmbajtura. Kanë rrethojën, nuk kanë shtigje për këmbësorë, bari dhe shkurret kanë mbuluar një pjesë të varrezave dhe nuk vërehet ndonjë mirëmbajtje e tyre.
18. Varrezat e qytetit të Drenasit janë të rrethuara me rrethojë dhe mirëmbajtja e pastërtisë në varreza është në nivel të mirë. Nuk kanë shtigje për këmbësorë dhe gjelbërimi nuk është i mirëmbajtur sa duhet, disa pjesë të varrezave janë të mbuluara nga bari. Varrezat gjenden në lokacion të përshtatshëm dhe ka hapësirë për parkim të automjeteve.
19. Në Rahovec, varrezat janë pjesërisht të rrethuara, mungojnë shtigjet për këmbësorë dhe mirëmbajtja e pastërtisë dhe gjelbërimit nuk është në nivelin e duhur. Lokacioni i varrezave nuk është i përshtatshëm, pasi që terreni është mjaft i pjerrët dhe mungon hapësira për parkim të automjeteve. Varrezat ortodokse nuk kanë shtigje për këmbësorë, rrethojat janë të dëmtuara, bari dhe shkurret kanë mbuluar një pjesë të varrezave dhe nuk vërehet ndonjë mirëmbajtje e tyre.

20. Varrezat e qytetit në Pejë kanë rrethoja dhe përkujdesja për pastërtinë në varreza është në nivel. Ka shtigje për këmbësorë, por nuk janë të mjaftueshme dhe mirëmbajtja e gjelbërimit nuk është e plotë. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm dhe ka hapësirë të mjaftueshme për parkim të automjeteve. Varrezat ortodokse dhe katolike kanë rrethojë mirëpo nuk kanë shtigje të mjaftueshme për këmbësorë, mirëmbajtja e gjelbërimit nuk është në nivel, bari dhe shkurret kanë mbuluar një pjesë të varrezave dhe nuk vërehet ndonjë mirëmbajtje e tyre.
21. Varrezat e qytetit në Klinë kanë rrethoja mirëpo ato nuk janë të kompletuara dhe të mirëmbajtura. Përkujdesja për pastërtinë dhe gjelbërimin në varreza nuk është në nivel. Ka mbeturina dhe disa varreza janë të mbuluara nga bari. Në disa pjesë të varrezave mungojnë shtigjet për këmbësorë ndërsa edhe shtigjet ekzistuese nuk mirëmbahen sa duhet. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm por nuk ka hapësirë për parkim të automjeteve. Edhe varrezat ortodokse janë në gjendje të ngjashme dhe nuk vërehet se ka mirëmbajtje të tyre.
22. Varrezat e qytetit në Kamenicë janë të rrethuara me rrethojë, e cila është e kompletuar dhe e mirëmbajtur por nuk ka shtigje për këmbësorë dhe gjelbërimi në varreza nuk mirëmbahet sa duhet. Lokacioni i varrezave nuk është i përshtatshëm pasi që rruga deri te varrezat është shumë e ngushtë dhe qasja është e vështirë, sidomos gjatë kryerjes së ceremonive mortore dhe nuk ka hapësirë për parkim të automjeteve. Varrezat ortodokse kanë rrethojë mirëpo nuk kanë shtigje të mjaftueshme për këmbësorë dhe nuk vërehet se ka mirëmbajtje të gjelbërimit.
23. Varrezat e qytetit të Vitisë janë të rrethuara me rrethoja, por në disa pjesë ato janë të dëmtuara dhe të pa mirëmbajtura. Mirëmbajtja e pastërtisë dhe gjelbërimit është në nivel të mirë por mungojnë shtigjet për këmbësorë. Mbajtja e gjelbërimit në varreza është në nivel të mirë. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm dhe ka hapësirë për parkim të automjeteve. Varrezat ortodokse kanë rrethojë mirëpo nuk kanë shtigje të mjaftueshme për këmbësorë dhe nuk vërehet se ka mirëmbajtje të gjelbërimit.
24. Varrezat e qytetit në Junik kanë rrethoja, përkujdesja për pastërtinë dhe gjelbërimin në varreza është në nivel. Ka shtigje për këmbësorë dhe mirëmbahen mirë. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm dhe ka hapësirë të mjaftueshme për parkim të automjeteve.
25. Varrezat e qytetit në Deçan kanë rrethoja por mungojnë shtigjet për këmbësorë. Përkujdesja për pastërtinë dhe gjelbërimin në varreza është në nivel. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm dhe ka hapësirë të mjaftueshme për parkim të automjeteve.
26. Varrezat e qytetit në Istog kanë rrethoja mirëpo ato nuk janë të kompletuara dhe të mirëmbajtura. Përkujdesja për pastërtinë dhe gjelbërimin në varreza nuk është në nivel. Vërehen mbeturina dhe disa varreza janë të mbuluara nga bari. Në disa pjesë të varrezave mungojnë shtigjet për këmbësorë ndërsa edhe shtigjet ekzistuese nuk mirëmbahen sa duhet. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm por nuk ka hapësirë për parkim të automjeteve.

27. Në Malishevë varrezat e qytetit kanë rrethoja mirëpo mungojnë shtigjet për këmbësorë. Mirëmbajtja e gjelbërimit dhe e pastërtisë nuk është në nivelin e duhur. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm por mungon hapësira për parkim të automjeteve.
28. Në Suharekë, varrezat e qytetit janë të rrethuara me rrethojë, kanë mirëmbajtje të pastërtisë dhe gjelbërimit por mungojnë shtigjet për këmbësorë dhe hapësira për parkim të automjeteve. Varrezat ortodokse nuk kanë shtigje për këmbësorë, bari dhe shkurret kanë mbuluar një pjesë të varrezave dhe nuk vërehet ndonjë mirëmbajtje e tyre.
29. Në Graçanicë, duke qenë se kapaciteti në varrezat e vjetra nuk ishte i mjaftueshëm, komuna ka bërë ndarjen e një lokacioni të ri për varreza. Lokacioni i ri është i përshtatshëm dhe ka filluar të përdoret për varrime edhe pse në disa raste qytetarët ende i varrosin të afërmit në varrezat e vjetra për shkak të afërsisë më të madhe me qytezën. Varrezat janë të rrethuara me rrethoja, kanë shtigje për këmbësorë, mirëmbajtja e pastërtisë dhe gjelbërimit është në nivel të mirë dhe ka hapësirë për parkim të automjeteve.
30. Varrezat në Dragash janë të rrethuara me rrethojë por mungojnë shtigjet për këmbësorë dhe nuk vërehet se ka mirëmbajtje të gjelbërimit në varreza. Lokacioni i varrezave është mjaft i papërshtatshëm-terreni është shumë i pjerrët dhe është shumë e vështirë realizimi i ceremonive mortore në një terren të tillë dhe nuk ka hapësira për parkim të automjeteve.
31. Varrezat në Mamushë janë të rrethuara me rrethojë dhe kanë shtigje për këmbësorë. Gjelbërimi dhe pastërtia mirëmbahen, lokacioni është i përshtatshëm por nuk ka hapësirë për parkim të automjeteve.
32. Në Shtime, varrezat e qytetit kanë rrethojën por mungojnë shtigjet për këmbësorë, mirëmbajtja e gjelbërimit dhe e pastërtisë është në nivel të mirë. Lokacioni është i përshtatshëm dhe ka hapësirë për parkim të automjeteve. Varrezat ortodokse nuk kanë shtigje për këmbësorë, rrethojat janë të dëmtuara, bari dhe shkurret kanë mbuluar një pjesë të varrezave dhe nuk vërehet ndonjë mirëmbajtje e varrezave.
33. Në Kaçanik dhe Han të Elezit, varrezat e qytetit kanë rrethoja të kompletuara por mungojnë shtigjet për këmbësorë dhe mirëmbajtja e gjelbërimit dhe e pastërtisë nuk është e rregullt. Lokacionet janë të përshtatshme dhe ka hapësira për parkim të automjeteve.
34. Në Shtërpcë, varrezat e qytetit kanë rrethojën dhe shtigjet për këmbësorë. Mirëmbajtja e gjelbërimit dhe pastërtisë është në nivel mesatar. Lokacioni është i përshtatshëm por nuk ka hapësirë për parkim të automjeteve.
35. Në Zubin Potok, varrezat kanë shtigje për këmbësorë, mirëmbajtja e gjelbërimit dhe e pastërtisë është relativisht e mirë dhe lokacioni i varrezave është i përshtatshëm. Në Leposaviq, varrezat e vjetra janë mbyllur dhe në lokacion të ri janë rregulluar varrezat e reja të cilat janë në gjendje të rregullt.
36. Varrezat e qytetit të Vushtrrisë janë të rrethuara me rrethojë, e cila është e kompletuar dhe e mirëmbajtur. Gjelbërimi dhe pastërtia mirëmbahen dhe janë në nivel. Shtigjet për këmbësorë nëpër varreza janë të rregulluara dhe ka hapësirë të mjaftueshme për parkim të automjeteve.

37. Në Skenderaj, komuna gjatë vitit 2016, ka ndarë një parcelë të re për varreza në fshatin Polac. Varrezat e reja janë të rrethuara me rrethojë por nuk kanë shtigje për këmbësorë. Mirëmbajtja gjelbërimit në varreza nuk është në nivelin e duhur ndërsa lokacioni i varrezave është i përshtatshëm.
38. Në Kllokot dhe Partesh, varrezat i kanë rrethojat dhe mirëmbajtja e gjelbërimit dhe pastërtisë në varreza është në nivel të mirë. Lokacioni i varrezave është i përshtatshëm dhe ka hapësirë për parkim të automjeteve. Varrezat në Ranillug kanë të vendosur rrethojën, mirëmbajtja e gjelbërimit dhe e pastërtisë është relativisht e mirë.
39. Varrezat e qytetit në Novobërdë kanë rrethoja por jo edhe shtigje për këmbësorë, mbajtja e pastërtisë në varreza është në nivel por mirëmbajtja e gjelbërimit në varreza nuk është e mjaftueshme. Rruga deri te varrezat është shumë e ngushtë, e papërshtatshme dhe qasja është e vështirë sidomos gjatë realizimit të ceremonive mortore. Varrezat ortodokse kanë rrethojat, pastërtia mirëmbahet por mirëmbajtja e gjelbërimit nuk është në nivel. Lokacioni është i përshtatshëm dhe ka hapësira për parkim të automjeteve.

Analiza Ligjore

40. Detyrimi i respektimit të dinjitetit të secilit person buron nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe është parimi bazë i përcaktuar edhe në dokumentet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 23 përcakton se *"Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut"*. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit kujton se edhe veprimet dhe vendimet e të gjitha organeve publike duhet të jenë në frymën e këtij përcaktimi, si parimi fundamental dhe kornizë e interpretimit të të drejtave themelore të çdo individi.
41. Mungesa e veprimeve adekuate, të autoriteteve lokale në fushën e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së varrezave dhe gjendja aktuale jo e rregullt e varrezave ndikon drejtpërdrejtë në cenimin e dinjitetit të të gjithë personave të cilët vizitojnë varrezat e të afërmeve të tyre, sidomos duke pasur parasysh ndjeshmërinë dhe gjendjen e tyre emocionale, gjatë realizimit të këtyre vizitave.
42. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike është kompetencë e Komunave, e përcaktuar në bazë të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale¹, neni 17, pika p, i cili përcakton si në vijim: *"Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:.....p) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike"*. Obligimet e komunave në fushën e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të varrezave, gjithashtu janë të përcaktuara edhe me statutet e komunave dhe me Rregullore komunale.
43. Në shumicën e komunave të Kosovës, duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, pika c, të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Statuteve të Komunave, rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave është rregulluar me Rregullore të veçanta për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e varrezave ose kjo çështje është rregulluar me Rregullore për shërbimet publike. Në të gjitha këto Rregullore parashihen kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e

varrezave si dhe organi përgjegjës për zbatimin e këtyre rregulloreve që në të shumtën e rasteve është Drejtoria e Shërbimeve Publike.

44. Rregullorja për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ në Komunën e Prishtinës², e miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, me datë 24 mars 2014, ndër tjera në nenin 32, sa i përket mirëmbajtjes së varrezave, përcakton si në vijim:

Me mirëmbajtje të varrezave nënkuptojmë:

- a) ndërtimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, pllakave, përmendoreve etj.;*
- b) mirëmbajtjen e gjelbërimit dhe luleve në varreza;*
- c) mirëmbajtjen e rrethojës së varrezave;*
- d) ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe shtigjeve pranë varrezave;*
- e) mbajtjen e pastërtisë në varreza;*
- f) mirëmbajtjen e infrastrukturës (rryma, uji, kanalizimi, ndriçimi, objekti etj.);*
- g) mirëmbajtjen e objektit komemorativ dhe*
- h) pastrimin e shtigjeve dhe largimin e borës dhe akullit nga to.*

45. Rregullorja për mirëmbajtjen, rregullimin dhe ruajtjen e varrezave e Komunës së Istogut³ e miratuar nga Kuvendi Komunal i Istogut, me datë 29 maj 2015, në nenin 11 përcakton aktivitetet e ndaluara në varreza, si: hyrja dhe dalja jashtë kohës kur varrezat janë të hapura për vizitor nëse prishet rendi dhe qetësia publike, hyrja e fëmijëve nën moshën 10 vjeçare pa përcjelljen e personave të rritur, kalimi i rrethojës së varrezave, shkelja e sipërfaqeve të gjelbëruara, thyerja e drunjtëve, këputja e luleve dhe bimëve tjera dekorative; shkelja njollosja dhe dëmtimi i varreve të ndërtuara si dhe vendit për rreth tyre, prishja e qetësisë në varreza, futja dhe kullotja e kafshëve në varreza, djegia e mbeturinave dhe gjerave tjera, e të tjera.

46. Në pothuajse të gjitha Rregulloret e komunave për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, ndër tjera, përcaktohen qartë përgjegjësitë e komunave në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e varrezave, sidomos duke pasur parasysh: rrethojat e varrezave dhe mirëmbajtjen e tyre, mirëmbajtja e hyrje daljeve, mirëmbajtja e shtigjeve të këmbësoreve, mirëmbajtja e gjelbërimit në varreza, mbajtja e pastërtisë dhe rendit në varreza, lokacioni i përshatshëm, mirëmbajtja e infrastrukturës, parkingjet për automjete, e të tjera.

47. Sipas praktikave ndërkombëtare, varësisht nga lokacionet individuale të varrezave, mirëmbajtja e varrezave, ndër të tjera kryesisht përfshinë: kujdesin dhe pastrimin e rrugëve të qasjes për këmbësorë dhe mjetet e transportit, mirëmbajtjen e kufijve të varrezave, portave dhe mureve të brendshme, largimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e shenjave dhe njoftimeve, nivelimin e terrenit sipas nevojës, mirëmbajtjen e gjelbërimit, mbjelljen dhe ruajtjen e hapësirave me lule, shkurtimin dhe kujdesin e pemëve dhe shkurreve, mirëmbajtjen e objekteve përcjellëse nëpër varreza, e të tjera.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11865>

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11479>

48. Sa i përket aspektit legjislativ, disa shtete këtë çështje e kanë të rregulluar me ligj të veçantë, si për shembull në Republikën e Kroacisë, çështja e varrezave është rregulluar me ligj të veçantë. Ligji për varreza i Kroacisë⁴ rregullon çështjen e ndërtimit, përdorimit dhe administrimit të varrezave, të cilat sipas këtij ligji janë objekte komunale të zotëruara nga njësia e vetëqeverisjes lokale, në territorin e së cilës ndodhen. Në këtë ligj gjithashtu përcaktohen obligimet e njësive të vetëqeverisjes lokale që të përkujdesen për administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave duke u bazuar në plotësimin e kriterëve dhe rregullave të përcaktuara me ligj si dhe përcaktohen afatet brenda të cilave duhet të nxirren aktet nënligjore lidhur me administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.

Konstatim i Avokatit të Popullit

49. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh gjendjen e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së varrezave, të paraqitur më sipër, konstaton se: Gjendja aktuale e varrezave nëpër disa nga komunat e Republikës së Kosovës, sa i përket menaxhimit dhe mirëmbajtjes së varrezave cenon dinjitetin e njeriut, të garantuar me Nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht dinjitetin e familjarëve të personave të vdekur. Gjithashtu niveli aktual i menaxhimit dhe mirëmbajtjes së varrezave paraqet edhe mos ushtrim të kompetencave nga autoritetet komunale, të parapara me Ligjin nr.03/L-040 për Vetëqeverisjes Lokale dhe mosplotësim të obligimeve të parapara me Rregulloret Komunale të miratuara nga Asambletë Komunale, e që përcaktojnë qartë përgjegjësitë dhe obligimet e komunave në fushën e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së varrezave.

50. Në bazë të vlerësimit të gjendjes së menaxhimit dhe mirëmbajtjes së varrezave nëpër komunat e Republikës së Kosovës, si dhe duke u nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe me qëllim të përmirësimit të gjendjes aktuale në të cilën ndodhen varrezat, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 18, nën paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit:

REKOMANDON

Komunën e Prishtinës

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të kompletohen rrethojat në varreza dhe të mirëmbahen.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e pastërtisë dhe gjelbërimit në varreza.

Komunën e Rahovecit

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të kompletohen rrethojat në varreza dhe të mirëmbahen.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e pastërtisë dhe gjelbërimit në varreza.

⁴ https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/full/1998_02_19_2290.html

Komunën e Klinës

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e pastërtisë dhe gjelbërimit në varreza.
- Të rregullohen rrethojat në varreza dhe të mirëmbahen.

Komunën e Istogut

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e pastërtisë dhe gjelbërimit në varreza.
- Të rregullohen rrethojat në varreza dhe të mirëmbahen.

Komunën e Vitisë

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të rregullohen rrethojat në varreza dhe të mirëmbahen.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e gjelbërimit në varreza.

Komunën e Pejës

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e gjelbërimit në varreza.

Komunën e Fushë Kosovës

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e pastërtisë dhe gjelbërimit në varreza.

Komunën e Kamenicës

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e gjelbërimit në varreza.

Komunën e Novobërdës

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e gjelbërimit në varreza.

Komunën e Obiliqit

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e gjelbërimit në varreza.

Komunën e Dragashit

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e gjelbërimit në varreza.

Komunën e Drenasit

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e gjelbërimit në varreza.

Komunën e Malishevës

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e pastërtisë dhe gjelbërimit në varreza.

Komunën e Skenderajt

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e gjelbërimit në varreza.

Komunën e Kaçanikut

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e pastërtisë dhe gjelbërimit në varreza.

Komunën e Hanit të Elezit

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e pastërtisë dhe gjelbërimit në varreza.

Komunën e Podujevës

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja gjithëpërfshirëse e varrezave.

Komunën e Shtimes

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja gjithëpërfshirëse e varrezave.

Komunën e Suharekës

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja gjithëpërfshirëse e varrezave.

Komunën e Ferizajt

- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e pastërtisë dhe gjelbërimit në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja gjithëpërfshirëse e varrezave.

Komunën e Gjilanit

- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e pastërtisë dhe gjelbërimit në varreza.
- Të sigurohet mirëmbajtja gjithëpërfshirëse e varrezave.

Komunën e Mitrovicës së Veriut

- Të sigurohet mirëmbajtja gjithëpërfshirëse e varrezave.

Komunën e Zveçanit

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.

Komunën e Deçanit

- Të bëhet hapja e shtigjeve të reja për këmbësorë në varreza.

Komunën e Gjakovës, Mitrovicës së Jugut dhe Lipjanit,

- Të sigurohet mirëmbajtja gjithëpërfshirëse e varrezave.

Në pajtim me nenin 132, parag.3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.") dhe nenin 28 të Ligjit Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarrja lidhur me çështjen në fjalë."), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,
Hilmi Dëshari
Avokat i Popullit